VENDIM
Nr. 628, datë 8.11.2023

PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT "*ECOLE INTERNATIONALE*", KU MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN FRËNGE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit të mesëm të ulët "*Ecole Internationale*", me kohë të plotë, i cili ushtron veprimtarinë arsimore, në adresën: rruga Tiranë–Elbasan, km 5, Lundër, Tiranë, me numër pasurie 867/19. Në këtë institucion arsimor mësimi zhvillohet në gjuhën frënge, ndërsa lëndët "Gjuhë shqipe", "Histori e kombit shqiptar" dhe "Gjeografi e Shqipërisë" zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit të mesëm të ulët "*Ecole Internationale*" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama